



Asistent Administrativ 3 (2 pozita)

Pejë (Ref. №: AKKVP 010/2019)

Niveli: Koefficienti 5.5; Grada 12

- Përgjegjës për mbështetje administrative në proceset që zhvillohen në kuadër të Drejtorisë Rajonale.
- Siguron mbështetje të përgjithshme administrative dhe teknike përfshirë postën zyrtare, telefonatat, skanimin, faksimi dhe kopjimin e dokumenteve, plotësimin e raporteve të shpenzimeve, si dhe hartimin e dokumenteve për takime të ndryshme;
- Përgatitë dhe modifikon dokumentet duke përfshirë korrespondencën, raportet, memorandumet dhe e-malit për mbikëqyrësin;
- Pranon dhe shpërndan korrespondencën në lidhje me lëndët dhe kujdeset për mbarëvajtjen e saj.
- Ruan dhe mirëmban sistemin elektronik dhe kopjet fizike të dokumenteve dhe dosjeve të zyrës.
- Ndihmon në shpërndarjen e informatave rreth Skemës së Qirasë së AKKVP-së tek institucionet përkatëse në Rajon dhe ofron këshilla dhe udhëzime për palët të interesuara sa u përket procedurave në lidhje me të drejtat pronësore dhe banesore në Kosovë
- Mbështet në procesin e ndarjes e përkohshme të pronave të braktisura si pjesë e Skemës së Qirasë së AKKVP-së; shtyp faturat dhe informon qiramarrësit për procedurat;
- Regjistron në baza ditore të gjitha të dhënat e inspektimeve në bazën e të dhënave;
- Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi

Kualifikimet dhe përvoja e punës:

- Shkolla e mesme dhe trajnim përkatës; preferohet diplomë universitare.
- (3) vjet përvojë pune përkatëse teknike administrative; p.sh. nga zyra e kadastrës, gjykata apo komuna;
- Certifikata në trajnime përkatëse do të ishte përparësi;
- Shkathësi të mira analitike, komunikuese, negociuese, koordinuese dhe ndër-njerëzore;
- Njohuri e gjuhës angleze;
- Njohuri në punën me kompjuter, posaçërisht Microsoft Office.
- Të jetë i përkushtuar ndaj barazisë, paanësisë, integritetit dhe të drejtave të njeriut;
- Të ketë aftësi për të punuar sipas standardeve të larta të punës dhe të jetë i organizuar dhe efektiv;
- Të ketë aftësi për të punuar me mbikëqyrje minimale dhe të jetë i kujdesshëm ndaj detajeve;
- Të ketë aftësi të mira për punë ekipore dhe për të vepruar brenda ambientit punues shumë etnik dhe shumë kulturor;
- Gatishmëri të udhëtojë në gjithë Kosovën.

Kjo pozitë është përcaktuar si pozitë e karrierës në bazë të paragrafit 1.1 të nenit 12 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: në shërbimin civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave ekzekutive, drejtuese ose zbatimin e funksioneve administrative dhe të cilët kanë aftësitë fizike, që kërkojnë për pozitën përkatëse.

Shënim: Procedura e rekrutimit është e rregulluar me Rregulloren nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Procedura e konkurrimit është e hapur për kandidatë të jashtëm, si dhe nëpunës civilë ekzistues.

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë. Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Detajet lidhur me përshkrimin dhe kushtet e punës për këtë pozitë mund të shkarkohen nga www.kpcva.org/jobs apo mund të merren në të gjitha zyrat e AKKVP-së.

Kandidatët e interesuar duhet të aplikojnë online përmes AKKVP ueb faqes: <http://kpcva.org/punesim.aspx>

Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Aplikacionet e pa kompletuara mund të refuzohen. Për shkak të numrit të madh të aplikacioneve të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni Zyrën e Burimeve Njerëzore përmes postës elektronike në: recruit@kpcva.org

Afati i fundit për të paraqitur aplikacionet është 27 Shtator 2019

ZYRAT E AKKVP /KPCVA OFFICES/KANCELARIJE KAUVI-a

ZYRAT E AKKVP/KPA OFFICES/KANCELARIJE KAUVI-a. Selia/Headquarters/Sedište; Perandori Justinian 71, Prishtinë/Priština, tel. 038 249 918, fax. 038 249 919. Gjilan/Gnjilane; Medllin Ollbrajt rr./ul/st. nr./br./no. 199, tel. 0280 320 289, fax. 0280 324 067. Mitrovicë/Mitroviica; Shemi Ahmeti nn, tel. 028 530 136/7, fax. 028 530 139, Pjesa Veriore e Mitrovicës/Severni deo Mitrovice; Filip Visnjic (ndertesa e Trepces/ zgrada Trepce / Trepca building) kati/sprat/floor 2 nr.18. Pejë/Peć; Mbretëresha Teutë str. No.85, tel. 039 431 668, fax. 039 432 970. Prishtinë/Priština; Rexhep Luci/ ex Goleška str. No.6 , tel. 038 225 473, fax. 038 244 854. Prizren; Jeronim De Rada, str. No: 74 (prapa qendrës tragtare - Ben Af /behind shopping center - Ben Af / iza tržnog centra – Ben Af) , tel. 029 231 469, fax. 029 231 429.

www.kpcva.org

Rr. "Perandori Justinian" Nr. 71/Ul. "Perandori Justinian" Br. 71/ Str. "Perandori Justinian" No. 71
10 000, Prishtinë/Priština - Tel: +383 (0)38 249-918 Fax: + 383 (0) 38 249 919